

AKTIVITETI I SHËRBIMIT LIGJOR FALAS TIRANË (TLAS), 2023

Viti 2023 ishte një periudhë e suksesshme për Shërbimin Ligjor Falas (TLAS). Kjo u shfaq me një numër të konsiderueshëm të klientëve të ndihmuar në çështje të ndryshme ligjore. Përveç kësaj, përmes punës sonë advokuese, hulumtuese dhe studimore, kemi pasur mundësi të ndërmerrnim më shumë iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi të drejtat e njeriut dhe për të ndikuar në ndryshimet dhe përmirësimin e legjislacionit.

TLAS vazhdoi të punojë me një staf të përkushtuar dhe të motivuar gjatë këtij viti, të cilët ishin të përfshirë në ofrimin e ndihmës juridike të cilësisë së lartë për klientët.

Në vitin 2023, TLAS vazhdoi të ofronte ndihmë ligjore falas për klientët në nevojë. Me një numër të madh të rasteve të pranuar (1207 raste në total), stafi i TLAS u përkushtua për të siguruar që çdo klient në nevojë të kishte akses në një avokat të specializuar në fushën e tyre.

TLAS ofruar shërbime ligjore falas, duke asistuar drejtpërdrejt 1207 çështje ligjore për të përkrahur fëmijët, të papunët, personat me aftësi të kufizuara, pensionistët, grupin LGBTI, minoritetet dhe familjet në nevojë. Më shumë se 98.5% e rasteve janë finalizuar me sukses në favor të përfituesve të shërbimit, duke ndihmuar në aksesin e tyre në drejtësi dhe në programet sociale, si dhe në përmirësimin e situatës së tyre ekonomike.

Gjatë vitit 2023, TLAS ka synuar përfaqësimet ligjore strategjike përpara administratës shtetërore dhe gjykatave, si dhe përforsimin e partneritetit efektiv me strukturat shtetërore, OJQ-të partnere apo përfaqësuesit në nivel lokal, për të plotësuar shërbimin ndaj shtresave apo individëve më të marginalizuar, duke mbrojtur të drejtat e tyre.

Sa i përket financimit, që mbetet një sfidë e vazhdueshme, TLAS ka arritur të sigurojë mbështetje financiare dhe të jetë efikas në shërbimet e tij, duke u bazuar në shumëllojshmërinë e formave të ofrimit, cilësinë e lartë dhe koston e ulët.

Synimi i TLAS në këtë vit ka qenë rritja e aksesit në drejtësi dhe në programet ekonomike dhe sociale, si dhe rritja e kapaciteteve dhe nxitja e profesionistëve të fushës së arsimit, shëndetësisë, gjëndjes civile dhe shërbimit social shtetëror për t'u përfshirë më shumë në zgjidhjen e nevojave të individëve në nevojë.

Në fund, TLAS-i dëshiron të falënderojë ekspertët, stafin dhe vullnetarët për kontributin e tyre të çmuar, si dhe donatorët për mbështetjen e tyre të vazhdueshme në realizimin e qëllimeve dhe misionit të organizatës.

FUSHA E LIGJIT NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TLAS vazhdoi gjatë vitit 2023 të ofrojë shërbime ligjore për çështjet civile, administrative, familjare dhe të punës si dhe për rastet e shkëljes së të drejtave të njeriut; në formën e këshillimit dhe të përfaqësimit si në organet administrative edhe në ato gjyqësore. Shërbimi Ligjor Falas i TLAS është i fokusuar tek familjet më të varfra, tek fëmijët vulnerabël, pensionistët, grupi LGBTI, individë me aftësi të ndryshme dhe kryesisht duke synuar

përfshirjen e tyre sociale.

Numri total i përfituesve të drejtpërdrejtë nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë 2022 ka qënë **1207** klientë, dhe numri total i të gjithë përfituesve të drejtëpërdrejtë gjatë 23 viteve të funksionimit të Shërbimit Ligjor Falas, TLAS, ka arritur shifrën **31403** klientë. Përqindja e shkallës së suksesit të çështjeve të përfaqësuara përpara gjykatave dhe strukturave administrative gjatë 2023 është si mëposhtë:

Lloji i shërbimit të ofruar në 2023	Numri i rasteve	Mbyllur në favor të klientit
Përfaqësime në gjykatë (ndihmë juridike dytësore)	416	98 %
Përfaqësime në administratë (ndihmë juridike parësore)	505	94 %
Shërbyer me ndihmë parësore dhe kliniks	286	n/a
Total	1207	

Mëposhtë gjeni diagramën progresive të përfituesve të drejtpërdrejtë të shërbimeve ligjore falas vit pas viti që nga themelimi i TLAS:




Tabela jep ngarkesën mujore të stafit që ofron shërbime ligjore për një total prej 1207 përfitues të drejtpërdrejtë gjatë vitit 2023:

Ndjekur	Status	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nen	Dhje
Avokatët	Hapur	230	255	275	294	313	328	344	344	365	385	408	416
	Mbyllur	10	15	21	28	39	67	92	96	126	176	212	264
	Aktive	220	240	254	266	274	261	252	248	239	209	196	152
Paraligjorët	Hapur	172	244	301	343	386	426	464	488	531	638	720	791
	Mbyllur	42	93	140	195	209	238	301	334	394	523	633	739
	Aktive	130	151	161	148	177	188	163	154	137	115	87	52
Total	Hapur	402	499	576	637	699	754	808	832	896	1023	1128	1207
	Mbyllur	52	108	161	223	248	305	415	402	520	699	845	1003
	Aktive	350	391	415	414	451	449	393	430	376	324	283	204

Në fund të muajit Dhjetor 2023, rezulton se janë ende në proces 152 çështje gjyqësore dhe 52 çështje administrative. Arsyet pse nuk ka qenë e mundur të finalizohen të gjitha çështjet janë të ndryshme: Lidhur me çështjet gjyqësore, së pari çështjet gjyqësore që janë hapur në tremujorin e fundit, nuk kanë asnjë mundësi të mbyllen në këtë afat; së dyti reforma në drejtësi, reformimi i gjyqtarëve ka sjellë reduktimin e numrit të tyre, gjë që ka shkaktuar zvarritje dhe zgjatje të kohës së parashikuar për të vecanta; së treti një çështje gjyqësore e pezulluar për shkak se është përjashtuar gjyqtari nga vettingu, hidhet në short nga e para edhe pse janë realizuar seanca të mëparshme të cilat kanë qenë drejt mbylljes; Çështjet administrative nuk janë aq problematike edhe pse janë mbartur 50 të tilla, vetëm se numri i përfituesve aplikantë për ndihmë juridike parësore në dy muajt e fundit të vitit ka qenë i madh dhe sigurimi i dokumentave të nevojshme kërkon kohën e duhur.

Lloji i çështjeve gjyqësore 2023	Total
Regjistrime lindjesh	43
Pavlefshmëri Akti Lindje, Martese, Vdekje, korigjim material, Emri, Mbiemri, Datëlindje, Vendlindje	26
Zgjidhje Martese	148
Kujdestari	32
Njohje atësie, amësie, Kundërshtim atësie, amësie	134
Stehim me qira dhe sociale/ asistence sociale	3
Shpërblim dëmi, heqje zotësie për të vepruar, pension, interseks	30
Totali për vitin 2023	416


Nga 416 çështje që janë ndjekur në rrugë gjyqësore nga avokatët e TLAS gjatë Vitit 2023, 152 prej tyre nuk janë mbyllur ose finalizuar brenda këtij harku kohor. Çështjet hapen sipas përkatësisë së vend banimit të përfituesve, duke i depozituar kërkesat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në të gjithë vendin, dhe rezulton që një numër i vogël prej tyre ankimohen në shkallët e tjera të gjyqësorit. Konkretisht nga viti 2023 janë mbartur 152 çështje të hapura në proces, nga të cilat vetëm një çështje është në Gjykatën e Lartë, një çështje gjykatën e Apelit Administrativ, dy në Gjykatën e Apelit dhe dy çështje janë në Gjykatën e Të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Vështirësitë e punës me gjykata janë ndjerë gjatë vitit 2023:

- për shkak të vetingut, gjykatat nuk kanë punuar me kapacitet të plotë stafi, kanë munguar në mënyrë të ndjeshme gjyqtarët;
- ndryshimeve të legjislacionit dhe në veçanti nga të Kodit të Procedurës Civile, i cili nga gjyqtarë të ndryshëm është interpretuar në mënyra të ndryshme, duke shtuar burokracinë, pushimin shpesh të pajustificuar të çështjeve, të gjitha në kurriz të kohëzgjatjes së çështjeve, të rritjes së kostove për paraqitjen e përsëritur të provave dokumentave të kërkuara, kostove të udhëtimeve dhe humbjes së kohës për finalizimin e çështjeve delikate që kanë të bëjnë me interesin më të lartë të fëmijëve, etj.


Për të parë se cilat kategori vulnerabël kanë përfituar nga shërbimet ligjore falas të TLAS gjatë vitit 2023, po japim të dhënat në tabelë dhe diagramën si mëposhtë:

Grupet përfituese	Ndjekur nga paraligjorët	Ndjekur nga Avokatët	Total
Fëmijë	359	43	402
Gra kryefamiljare	136	126	262
Persona me aftësi të kufizuar dhe invalidë	10	1	11
Të papunë	165	152	317
Pensionist	22	5	27
Familje të varfra	99	89	188
Total: 2023	791	416	1207



Numri i përfituesve sipas llojit të cështjes gjatë 2023 në tabelë dhe në diagramë parqiten si mëposhtë:

Llojet e Rasteve	Paraligjor	Avokat	Total
Regjistrim Lindje	359	43	402
Regjistrime të tjera civile, korrigjime të dhënash, martesë, pavlefshmëri aktesh	68	26	94
Zgjidhje martese	43	148	191
Kujdestari	17	32	49
Kundërshtim atësie/mëmësie - Njohje atësie/mëmësie	42	134	176
Stehim me qera dhe sociale/ asistence sociale	147	3	150
Shpërblim dëmi, heqje zotësie për të vepruar, pension, të drejtat e njeriut, etj.	115	30	145
Total: 2023	791	416	1207



Pas 24 vitesh aktivitet dhe eksperiencë në fushën e ofrimit të shërbimeve ligjore falas, TLAS është sa i njohur edhe po aq i kërkuar nga përfituesit, nga partneret dhe antarët e rrjetit të krijuar në zonat e targetuara dhe ndërhyrjes në të gjithë territorin e vendi në përputhje me projektet e mbështetura nga donatorët tanë. Bashkëpunorët tanë dhe përfituesit e drejtpërdrejtë tashmë janë të mirëorientuar për të përdorur telefonin pa pagesë të zyrës, aksesuar adresën në Tiranë, drejtuar emaille të drejtpërdrejta por edhe përmes faqes së internetit dhe Portalit të TLAS të dedikuar për këtë qëllim.

Gjatë vitit 2023 pati disa burime referimesh dhe rekomandimesh në TLAS nga partnerë apo rrjeti i ndërtuar tashmë i bashkëpunimit me aktorë të interesuar dhe organizata komunitare nga i gjithë vendi:

	Burimet e referimit të rasteve/përfituese në TLAS gjatë 2023	Numri Përqindja
1	Zyrat e Gjendjes Civile	301 = 25%
2	Njesitë e mbrojtjes së fëmijëve/CPU	193 = 16%
3	Klient direkt	375 = 31%
4	OJF/Organizata me bazë komunitare	61 = 5%
5	Shërbimi Social	37 = 3%
6	Web/Portal/Email	96 = 8%
7	Network/LAN	144 = 12%
	Nr. Total i përfituesve të drejtpërdrejtë	1207 ose 100 %

Objektivat e përcaktuara nga TLAS për 2023 janë arritur në përputhje me kontratat e nënshkruara me donatorët, edhe pse zhvillimet dhe ndryshimet e diktura nga reformat e ndryshme të ndërrmarra kudo nga qeveria shqiptare si në sistemin e ekonomisë, atë social, territorial apo të drejtësisë kanë qenë intensive, me efekte të drejtpërdrejta dhe të paparashikuara për jetët e familjeve apo individëve vulnerabël.

Përsa i përket objektivit 2, të rritjes së ndërgjegjësimit të grupeve në nevojë dhe të aktorëve që ofrojnë shërbime ndaj tyre, TLAS ka zbatuar një sërë aktivitete të rëndësishme. Organizimi tradicional shumë vjeçar dhe i sukseshëm i TLAS i aktiviteteve street laë, ka qenë më intensiv se viti paraardhës nga ku, aktivitetet në terren i reduktuam si shkak i masave të Covid-19.

2/1 Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar nga grupi i studenteve të TLAS disa vizita si mëposhtë :

NR	Vendi: njësiti administrative dhe bashkitë	Data	Numri i qytetareve të takuar	Numri i publikimeve të shpërndara
1	Pogradec	21.02.2023	45	52
2	Berat	06.04.2023	35	46
3	Elbasan	25.04.2023	24	39
4	Korce	11.05.2023	38	42
5	Berat	26.05.2023	27	32

6	Elbasan	22.11.2023	24	39
7	Tirane	25.10.2023	24	26
8	Berat	13.11.2023	21	35
9	Tirane	17.10.2023	59	61
10	Korce	16.11.2023	30	59
11	Durres	28.02.2023	24	32
12	Korce	19.01.2023	43	59
13	Korce	11.05.2023	36	41
14	Fier	28.09.2023	54	63
15	Shkoder	04.07.2023	21	29
16	Tirane	17.10.2023	59	61
TOTALI	16		564	716

2/2 Trajnime të ofruara nga ekspertët e TLAS gjatë 2023 për 391 pjesëmarrës sipas tabelës mëposhtë, përfitues kanë qenë anëtarë të rrjeteve të bashkëpunimit të TLAS nga strukturat lokale dhe partnere të shoqërisë civile si Shërbimet Sociale, Njesitë për mbrojtjen e fëmijëve, punonjës të gjendjes civile, të institucioneve të arsimit, shëndetësisë, policisë dhe organizatave me bazë komunitare, etj.

TRAJNIME

Numri	Qyteti	Data	Vendi	Nr. i pjesm	Tema
1.	Tiranë	13.01.2023	Xheko Imperial	34	<i>“Fuqizimi i mbrojtjes nga diskriminimi në nivel lokal”</i>
2.	Gjirokastrë	27.03.2023	Bashkia Gjirokastrë	10	<i>Fokus Grup</i>
3.	Sarandë	28.03.2023	Bashkia Sarandë	8	<i>Fokus Grup</i>
4.	Korcë	03.04.2023	Bashkia Korcë	12	<i>Fokus Grup</i>
5.	Kukës	06.04.2023	Bashkia Kukës	10	<i>Fokus Grup</i>
6.	Shkodër	04.05.2023	Bashkia Shkodër	10	<i>Fokus Grup</i>
7.	Korcë	03.05.2023	ZOOM	18	<i>“Të rrisim aksesin në drejtësi në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale”</i>
8.	Elbasan	04.05.2023	ZOOM	22	<i>“Të rrisim aksesin në drejtësi në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale”</i>
9.	Berat	09.05.2023	ZOOM	19	<i>“Të rrisim aksesin në drejtësi në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale”</i>

10.	Pogradec	10.05.2023	ZOOM	20	<i>“Të rrisim aksesin në drejtësi në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale”</i>
11.	Tiranë	11.05.2023	ZOOM	23	<i>“Të rrisim aksesin në drejtësi në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale”</i>
12.	Fier	09.06.2023	Bashkia Fier	22	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
13.	Berat	16.06.2023	Prefektura Berat	21	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
14.	Vlorë	20.06.2023	Prefektura Vlorë	19	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
15.	Gjirokastrë	21.06.2023	Prefektura Gjirokastrë	21	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
16.	Shkodër	04.07.2023	Bashkia Shkodër	27	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
17.	Lezhë	04.07.2023	Bashkia Lezhë	24	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
18.	Gjirokastrë	05.07.2023	Bashkia Gjirokastrë	28	<i>“Rritja e efektivitetit të zbatimit të legjislacionit të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, fëmijët e pashoqëruar, refugjatë, azilantë dhe të huaj”</i>
19.	Tiranë	24.07.2023	Tirana Legal Aid Society's office	10	<i>“Tryezë konsultimi për Rapid Assessment Report”</i>
20.	Tiranë	26.07.2023	ZOOM	15	<i>“Tryezë konsultimi për Rapid Assessment Report”</i>
21.	Tiranë	20.10.2023	Hotel Tirana International	24	<i>Fëmijët që jetojnë në kushte vulnerabiliteti përfitojnë mbështetje ligjore falas”</i>
22.	Tiranë	14.12.2023	Hotel Tirana International	21	<i>“Prezantim i Indeksit të pashtetësisë për Shqipërinë”</i>

3/1 Grupi i ekspertëve të TLAS gjate vitit 2023 ka draftuar:

Komentari i plote gjendet ne www.tlas.org.al

“MARTESAT FIKTIVE NË SHQIPËRI” - ANALIZË MBI TË DHËNAT E GJENDJES CIVILE DHE VENDIMEVE GJYQËSORE

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), me mbështjetjen financiare të granteve të vogla të Ambasadës Amerikane në Shqipëri u angazhua për realizimin e një studimi analitik ligjor dhe social të fenomenit të martesave fiktive¹, për gjetjet dhe rekomandimet që dalin për ndryshimet e nevojshme ligjore në drejtim të përmirësimit të mekanizmave ligjorë në mënyrë që strukturat shtetërore dhe sociale të jenë më të kujdesshëm e më të kontrolluar për të minimizuar e shmangur pasojat që vijnë si rezultat i martesave fiktive.

Studimi u mbështet në monitorimet e të dhënave të siguruara nga Shërbimi i Gjendjes Civile, nga Gjykatat e Shkallës së Parë, nga INSTAT dhe në mënyrë të ndjeshme rezulton që trendi i viteve të fundit në Shqipëri shënon rritje të numrit të martesave fiktive. Ajo që bie në sy si një tipar dallues është se në martesat fiktive janë burrat ata që marrin mbiemrin e gruas me qëllimin për të humbur gjurmët dhe shmangur problemet që ju dalin nga expulset, extradimet apo nga rekorde të tjera kriminale, që mund të jenë kryer në Shqipëri apo jashtë saj. Po ashtu del se numri më i madh i grave të përfshira në këto lloj martesash i përket komunitetit Rom dhe Egjiptian, por jo vetëm, nga mazhoranca numri nuk është i papërfillshëm...”

HISTORI TE VËRTETA

Fëmija EZ e cila nuk disponon asnjë lloj dokumenti për t’u regjistruar si shtetase shqiptare, për arsye se ka lindur në kushte shtëpie.

IZ dhe MZ kanë lidhur martesë ligjore më 07.05.2014. Nga kjo martesë kanë sjellë në jetë 6 fëmijë, pesë prej të cilëve janë të regjistruar në zyrën e gjendjes civile të Njësisë Administrative Rajoni 3, Berat, pasi kanë lindur në institucione shtetërore (katër prej tyre në spitalin e Beratit dhe një prej tyre në Greqi). Fëmija EZ - i tretë në radhë, ka mbetur e

¹ Me martesa fiktive kuptojmë të gjithë ato martesa të cilat nuk konsumohen as edhe një ditë të vetme në kuptimin që njeh ligji, që do të thotë se përveçse kryhen veprimet procedurale administrative nga zyrtarë përkatës të gjendjes civile në praninë e dy bashkëshortëve dhe me vullnetin e tyre të plotë, kjo lloj martese shoqërohet me mungesën e bashkëjetesës, të komunikimit ndërmjet bashkëshortëve, të marrëdhënieve intime, të mbështjetjes morale apo materiale, me mungesën e gjërave të përbashkëta, të buxhetit të përbashkët e shumë fakte të tjera të verifikueshme për ekzistencën e institucionit të martesës;

paregjistruar për arsye se ka lindur në kushte shtëpie (kasolle të improvizuara), në një fshat të Athinës në Greqi.

EZ aktualisht është 7 vjece dhe ende nuk figuron e regjistruar pasi familjarët e saj nuk disponojnë asnjë lloj dokumenti për regjistrimin e saj.

Gjendur në këto kushte, TLAS bazuar në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile - “Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale ose pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë të zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë” – e ndoqi çështjen në rrugë gjyqesore.

Gjithashtu, mori përsipër testin e ADN-së fëmijës EZ për të parë nëse profilet gjenetike nënë-bijë përputheshin. Nëpërmjet ekzaminimit tampon-pështymë u vërtetua lidhja familjare e nënës dhe fëmijës me initiale EZ. Aktualisht çështja ndodhet në Gjykatë, e cila pritet të bëjë vërtetimin e faktit juridik të fëmijës EZ e cila më pas të ketë mundësi të gëzojë të drejta sic do shtetas shqiptar i këtij vendi.

Historia e shtetases GJSH

Shtetësja GjSh ka lidhur martesën ligjore me babain e fëmijëve të saj me 01.02.2011. Nga martesa e tyre dy bashkëshortët kanë sjellë në jetë katër fëmijë.

Rezulton të kenë regjistruar në gjendjen civile vetëm njërin prej tyre, SSh të datëlindjes 18.12.2010, gjë e cila provohet nga certifikata familjare e lëshuar më datë 30.05.2023.

Tre fëmijët D.Sh, A.Sh dhe A.Sh, ata nuk janë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile (RKGJC) për arsye se nuk kanë pasur dokumente që të vërtetojnë lindjen e tyre.

Tre fëmijet kanë lindur në shtëpi të improvizuara (cadra) sepse kjo familje ka qenë në lëvizje në territore të ndryshme të Shqipërisë për të gjetur punë, në mënyrë që të siguronin të ardhura për jetesën, shpeshherë fëmijët i nxjerrin dhe për të lypur.

Në lindjen e fëmijëve kërkuesja është ndihmuar nga familjarët e saj dhe për këtë arsye ajo nuk disponon dokument për lindjen e tre fëmijëve (certifikatë asistence në lindje).

Nena dhe babai i fëmijëve, janë paraqitur në zyrën e gjendjes civile për të bërë deklarinimin e lindjes, por zyra e gjendjes civile e ka refuzuar regjistrimin me arsyetimin se ju nuk keni dokument që të vërtetoni lindjen “Certifikatën e Asistences në lindje”, duke ju referuar nenit 38, të ligjit të “Për gjendjen civile”.

Duke mos patur një dokument që vërteton lindjen, prinderit e patën të pamundur të bënin më pas, regjistrimin e fëmijëve, në zyrën e gjendjes civile, pasi referuar nenit 38, të ligjit 10129/2009, “Për gjendjen civile”, kërkesa iu refuzua nga nëpunësit e gjendjes civile. Për këtë arsye edhe sot e kësaj dite, të tre fëmijët, e moshes 18 vjec, 17 vjec dhe 9 vjec rezultojnë akoma të paregjistruar në zyrën e gjendjes civile ku prindrit kanë vendregjistrimin.

Fëmija i tretë në radhë, e cila thirret me emrin A.Sh e datëlindjes 20.08.2006 është bërë nënë. Edhe pse është bërë nënë A.Sh dhe fëmija e saj e lindur në Maternitetin e Tiranës kanë mbetur të paregjistruara si pasojë e mosregjistrimit të A.Sh.

Ky rast i është referuar Shërbimit Ligjor Falas Tirane, nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve e Bashkisë Tiranë, pasi nëna dhe fëmijët janë konstatuar në situatë rruge duke lypur.

Një fëmijë i paregjistruar nuk mund të realizojë asnjë të drejtë që lidhet me detyrimin e shoqërisë për përkujdesje, duke filluar që nga të drejtat më bazike si, njohja e prindërve, e

drejta për përkujdesje spitalore, e drejta për t'u arsimuar, e drejta për të patur një shtetësi të caktuar, etj si dhe rrezikohet të bëhet objekt i veprimtarive kriminale të trafikimit etj., pasi nuk ka një person të ngarkuar ligjërisht me përgjegjësinë e përkujdesjes e cila ka në bazë përgjegjësinë prindërore ose kujdestare.

1. Ekspertiza e TLAS në Takimet e Grupve Ndërsektoriale

Gjatë vitin 2023 bashkëpunimi me grupet ndërsektoriale ka qënë shumë intesiv. Stafi I TLAS ka marrë pjesë në 4 takime të grupeve teknike ose të GTN've. Gjatë këtyre takimeve që janë organizuar nga Punonjësit për mbrojtjen e femijeve nga Njësitë Administrative në Tiranë janë diskutuar shumë problematika të ndryshme pranë familjeve të cilat kanë probleme te veshtira ekonomike.

Nr.	Date	Problematika	Organizuar
1.	17.07.2023	Fëmijët KH, MH dhe AH konkretisht 16, 12 dhe 8 vjeç janë të vendosur pranë banesës së dajës së tyre EH që prej disa ditësh. Me datë 05.06.2023 babai I fëmijëve AM plagos me thikë nënën e fëmijëve MM duke e lënë në gjendje shumë të rëndë. Nëna e fëmijëve ka qëndruar për rreth një muaj në gjendje kome në spital, ku para disa ditëve humbi jetën. Në momentin e konfliktit mësohet se fëmijët ishin nxjerrë jashtë banesës nga çifti. Pas plagosjes në banesë ka hyrë vajza e madhe KM, e cila më pas ka lajmëruar policinë. Nga biseda e realizuar me fëmijët, MM (vajza e vogël) ka qënë prezente dhe situata ka mbetur traumatike tek fëmija. Babai i fëmijëve AM ka qënë përdorues i alkoolit dhe ka ushtruar dhunë të herëpashershme tek bashkëshortja e tij. Aktualisht fëmijët janë të vendosur pranë shtëpisë së dajës EH, në një banesë me kushte të përshtatshme për jetesë por nisur nga vlerësimi daja nuk ka gjendje ekonomike për të përballuar shpenzimet. Arsyet per raportim: shqetësimi për mbrojtjen e fëmijës: • Nevojë emergjente për trajtim me psikolog të specializuar për të tre fëmijët; • Mbështetje për trajtim shëndetësor për fëmijën AM i cili është i diagnostuar me	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF Tiranë)

		epilepsi për përgatitjen e dokumentacionit për kemp; • Nevojë për mbështetje me ilaçe për fëmijën AM • Mbështetje për dajën për fitimin e kujdestarisë së tre fëmijëve • Nevojë për veshje për fëmijët; Asistim për transferimin e shkollës.	
2.	13.10.2023	Takimi i Grupit Teknik Ndërsektorial mbi rastin A.K u mbledh në kuadër të menaxhimit të rastit të dy fëmijëve të mitur të rikthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak dhe për rishikim të progresit mbi masat e parashikuara nga GTN e fundit e dt.23.06.2023. Si fillim u diskutuan masat e ndërmarra nga PMF dhe aktorët e tjerë të përfshirë në procesin e menaxhimit, të parashikuara nga rishikimi i fundit i Planit Individual të Mbrojtjes të dt.23.06.2023, dhe progresi që ka bërë rasti në 3 muaj e fundit në procesin e ri-integrimit të plotë në komunitet. Në zbatim të planit të masave të parashikuara në rishikimin e PIM të dt.23.06.2023, PMF Lagjja Nr.12 ka qënë në monitorim të vazhdueshëm të rastit përmes vizitave në terren, takimeve në ambjentet e njesisë dhe bisedave telefonike. Gjithmonë referuar Planit Individual të Mbrojtjes janë ofruar shërbimet në bashkëpunim me aktorët pjesë të procesit të menaxhimit dhe që kanë marrë përsipër detyrat. Në mënyrë periodike (periudha korrik-shtator 2023) janë mbajtur kontaktet me Terre des Homme mbi ofrimin e shërbimeve sipas nevojave të rastit (dorëzimi i Gift Card mujore për ushqime, mbulim kostosh administrative ku përfshihen pagesat e uje / energji elektrike / pagesë qiraje, mbulim kostosh për veshje dhe artikuj të tjerë shtëpiakë, kostot mujore të kursit të futbollit për secilin fëmijë dhe sipas nevojave specifike të familjes. Kontakte periodike (periudha korrik-shtator 2023 dhe takime me stafin (psikosocial, mësues kujdestar) e shkollës 9-vjecare "Klodian Tanushi" dhe shkolla profesionale "Gjergj Canco" mbi ecurinë dhe frekuentimin e shkollës nga fëmijët. Kontakte me mësuesin mbështetës, psikologë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rastit si CVE, ZVA Tiranë, Terre des Homme, LKGV. (periudha korrik-shtator 2023). Gjatë takimit u diskutuan	

		vështirësitë që ka patur PMF në menaxhimin e rastit dhe aktorët e tjerë në ofrimin e shërbimeve. Disa nga problematikat e ngritura gjatë takimit ishin: Vështirësia për gjetjen e një punë të përshtatshme për nënën duke marrë parasysh nivelin arsimor (I lartë) dhe indoktrinimin fetar radikal. Rezistenca që nëna shfaq herë pas here në komunikim me PMF Lagjja Nr.12 dhe në marrjen e shërbimeve të ofruara nga institucione të ndryshme. Problematikat që ka shfaqur djali I madh F.M në frekuentimin e shkollës, përshtatjen me bashkëmoshatarët dhe stafin e shkollës. (mësues, psikolog). Nisur nga sa më sipër dhe në vijimësi të menaxhimit të rastit dhe ofrimit të shërbimeve aktorët pjesmarrës në takim ranë dakort që të ndërmerren hapat si më poshtë: Mbulimi i shpenzimeve noteriale të kontratës së re të qirasë ndermjet pronarit dhe rastit A.K.- Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS).	
3.	24.05.2023	Familja përbëhet nga gjashtë anëtarë, dy prindërit BSH, GJSH dhe 4 fëmijët DSH 18 vjeç, SSH 12 vjeç, ASH 8 vjeç dhe ASH 16 vjeç. Familja ndodhet me gjendje civile në qytetin e Sarandës dhe jeton në barake në zonën e Bregut të Lumit. Fëmijët DSH, ASH dhe ASH nuk janë të regjistruar në gjendje civile. Vajza ASH bashkëjeton me EB me të cilin ka dhe një fëmijë i cili ka pak javë që ka ardhur në jetë. Gjithashtu dhe fëmija i ASH nuk është regjistruar në gjendje civile. DSH bashkëjeton me partneren e tij me të cilën ka dhe një fëmijë. Nëna GJSH është konstatuar nga skuadra e terrenit në situatë rruge duke lypur së bashku me fëmijët SSH, ASH dhe ASH. Të ardhurat e familjes sigurohen nga aktiviteti i lypjes. Babait të fëmijëve BSH i është ofruar mundësia për ta referuar te Drejtoria e Nxitjes së Punësimit, por nuk ka pranuar duke thënë që nuk është interesuar sepse nxjerr të ardhura duke punuar me makinën e tij. Familja është mbështetur në muajin Prill me pako ushqimore nga Qendra Komunitare Multidisiplinare. Prindërit janë informuar për procedurat që duhet të ndjekin për bonusin e qirasë. Gjithashtu ata janë informuar që fëmijët nuk duhet të dalin për të lypur, duhet të ndjekin shkollën dhe shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve dënohet me ligj. Prindërit gjithmonë ankohen por nuk bashkëpunojnë për të ndjekur procedurat për fuqizmin ekonomik.	
4. 13		Shtetësja SP është shprehur se është e martuar me një shtetas shqiptar të Maqedonisë së Veriut që prej vitit 2000 dhe gjatë gjithëkësaj kohe kanë jetuar në qytetin e Tetovës, Maqedoni. Ajo është nënë e 3 fëmijëve , dy	

	djemve dhe një vajze të mitur. Gjatë këtyre 23 viteve ndaj saj është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike në mënyrë sistematike nga vjehrra, kunata, kunati dhe bashkëshorti. Për shkak se bashkëshorti i saj ishte punonjës i policisë, denoncimet e zonjës nuk janë marrë për bazë. Vitet e fundit dhuna ishte bërë edhe më e shpeshtë ndaj saj, por kishte vijuar edhe dhuna psikologjike ndaj vajzës. itura SP është shtetase maqedonase e regjistruar në qytetin e Tetovës por aktualisht jeton në shtëpinë e gjyshërve të nënës në Çekrezë, në Njësinë Administrative Zall -Herr. Gjatë kësaj kohe është bërë i mundur regjistrimi i vajzës në shkollën 9 vjecare “Haxhi Korra”. itësja SP dhe vajza janë kthyer në Shqipëri, në datë 03.10.2023 ka ardhur bashkëshorti me djalin e madh të cilët janë përfshirë në një konflikt fizik me zonjën, babain dhe vëllain e saj. Pas këtij momenti bashkëshorti dhe djali i madh janë drejtuar në komisaratin nr.5 për të bërë kallëzim për dhunë ndaj babait dhe vëllait të zonjës, ku ky i fundit është arrestuar. Zonja shpreh se aktualisht vëllai ka dalë nga burgu dhe ndaj tij është marrë masa “detyrim paraqiteje”. Zonja është pyetur nëse ka dëshirë të strehohet në një qendër emergjence apo strehë për gratë e dhunuara për arsye sigurie ndaj saj dhe familjes, por e ka refuzuar duke shprehur se ndihet e sigurt në familjen e saj. Ajo referon se ka mbështetjen e babait dhe të vëllait dhe në vijim do të qëndrojë tek ta deri në momentin që do të fuqizohet për të jetuar e vetme me vajzën. a është pajisur më urdhër mbrojtje nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për një periudhë prej 6 muajsh , deri më datë 08.04.2023. Grupi Teknik Ndërsektorial vendosi: Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësinë Administrative Zall Herr do të vazhdojë me menaxhimin dhe monitorimin e rastit. PMF do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me nënën dhe vajzën e mitur për cdo dinamikë apo nevojë që do të kenë. Mbështetje për procedurat ligjore u ofruan nga TLAS.	
--	--	--